

**1. Rendit sipas radhës fjalët në skemën e tekstit argumentues:**

- Përkufizimi i problemit
- Antiteza
- Paraqitja e antitezës
- Përfundimi
- Paraqitja e tezës
- Rrëzimi i argumenteve

**2. Sipas mendimit tim, hartimi i Historisë së Letërsisë kërkon një rivlerësim të dukurive letrare.**

- a) Argument objektiv
- b) Argument subjektiv

**3. Sipas Cabejit, tri qarqet e para janë parakombëtare.**

- a) Argument objektiv
- b) Argument subjektiv

**4. Unë nuk mendoj se zgjidhja më e mirë është të ndalohet fëmija të shohë televizor.**

- a) Argument objektiv
- b) Argument subjektiv

**5. Nga një studim i kryer me 20 mijë persona është arritur në konkluzionin se njerëzit që kanë grupin e gjakut 0, janë më pak të prirë për t'u goditur nga infarkti.**

- a) Argument objektiv
- b) Argument subjektiv

**6. 895 mijë duhanpirës janë në Shqipëri.**

- a) Argument objektiv
- b) Argument subjektiv

Pyetjet	1	2	3	4	5	6
Përgjigjet e sakta	1. Përkufizimi i problemit 2. Paraqitja e tezës 3. Antiteza 4. Paraqitja e antitezës 5. Rrëzimi i argumenteve 6. Përfundimi	b	a	b	a	a